URDHËR
Nr. 78, datë 29.1.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E KOSOVËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, e tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) mishit të freskët;
ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes që vërteton mosprezencën e virusit;
d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të Pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;
dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:
65°C në 39.8 sekonda;
70°C në 3.6 sekonda;
74°C në 0.5 sekonda;
80°C në 0.03 sekonda;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.
Nga shteti i Kosovës, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	**Kosovë**	**Gjilan***
2.	**Kosovë**	**Gjakovë***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Kosovës të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.
3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.
4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 1.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj